



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.12/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.Sh.P. “Fauna Jonë” me seli në Kamenicë, Krenidel p.n. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.SH. nga Kamenica, dhe “Agrounion” ShPK me seli në Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.SH.1., kundër të paditurit Kuvendi Komunal Kamenicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.H., me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.96/23 të datës 31.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Kamenicës, e datës 23.11.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.96/23 i datës 31.07.2023, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, në pikën I të dispozitiv ka vendosur: I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve N.Sh.P “Fauna Jonë” dhe “Agrounion” ShPK, Anulohen si të kundërligjshëm vendimi nr. 29495 i datës 19.09.2018 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave pranë të paditurit Komuna e Kamenicës dhe Vendimi nr.30618 i datës 02.09.2014 i Kuvendit Komunal Kamenicë. Në pikën II. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Në pikën III. Lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit, paditësi udhëzohet në procedurë kontestimore. Në pikën IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e tij, për shkak të; të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes esenciale të dispozitave procedurale.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194,i Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK),ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se organi i paditur, me vendimin nr.29495 të datës 19.09.2018 nën pikën I. të dispozitivit të vendimit, ka refuzuar ankesën me nr. 01-016-31718 datë 11.09.2014 e parashtruar nga konzorciumi “Fauna Jonë” dhe ShPK “Agrounion”, me pronar R.SH.1. dhe R.SH., lidhur me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me qira të vendgjyjetisë në Territorin e Komunës së Kamenicës, si e pa bazuar. Nën pikën II. Ka vërtetuar vendimin e Kuvendit të Komunës nr.30618 datë 02.09.2014, për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër.

I pakënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi, me padi iniciacion konflikt administrativ në procedurë gjyqësore. Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, në këtë çështje juridike administrative të paditësit, mban seancë të shqyrtimit kryesor me datë 27.07.2023, në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave, bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin, e aprovon kërkesëpadinë e paditësve dhe anulon vendimin nr.29495 të datës 19.09.2018 dhe vendimin nr.30618 të datës 02.09.2014 të Kuvendit Komunal Kamenicë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri nuk ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit ndaj vendimit nr.30618 të datës 02.09.2014 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër, për shkak se paditësit përmes provave të dorëzuara kanë dëshmuar se kanë qenë të përgjegjshëm, ndërsa i padituri nuk ka vepruar sipas vendimit të gjykatës për sjelljen e kopjes së pa hapur të ofertës paditësve për të konstatuar dokumentet që janë dorëzuar së bashku me ofertë nga paditësi. Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata me procesverbalin e datës 06.07.2023 e ka obliguar të paditurin që të dorëzoj zarfin e dytë-kopjen e ofertës paditësve ose nëse i njëjti është hapur, përbërjen e komisionit dhe procesverbalin e hapjes së zarfit, mirëpo pavarësisht detyrimit e paditura as në përgjigje në padi e as në seancën e shqyrtimit kryesor obliguar sipas procesverbalit të datës 06.07.2023 nuk ka dorëzuar zarfin e dytë-kopjen e ofertës së paditësve apo eventualisht procesverbalin e hapjes së të njëjtit. në këtë kuptim gjykata ka vlerësuar se i padituri nuk ka provuar me asnjë provë të vetme pretendimin se në rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes komisioni për shqyrtimin e ankesave ka vendosur që të refuzoj ankesën e paditësve për shkak se është shikuar kopja dhe origjinali i ofertës dhe se është vërejtur se me rastin e ofertimit ka munguar deklarata nën betim e OE: Agrounion ShPK. Gjukata ka konstatuar se Kuvendi Komunal Kamenicë me datë 31.01.2011 ka miratuar vendimin 01 nr.08 për themelimin e vendgjyjetisë në territorin e Kamenicës dhe ka obliguar Zyrën e Prokurimit që në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr.06/2009 për Dhënien në menaxhim të vendgjyjetive të përbashkëta dhe duke u zbatuar procedurat e parapara me Ligjin për Prokurimin Publik të përzgjedh subjektin për menaxhimin e vendgjyjetisë. Lidhur me këtë gjykata ka konstatuar se i padituri ka zhvilluar procedurën e dhënies me qira të vendgjyjetisë në Kamenicë në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik. Gjukata ka konstatuar se i padituri nuk i është përmbajtur obligimeve ligjore që gjykatës ti dorëzoj zarfin kopje të mbyllur apo procesverbalin

e hapjes së këtij zarfi në mënyrë që të vërtetohet gjendja faktike e konstatuar nga i padituri në vendimin kontestues dhe atë se anëtari i konzorciumit nuk e ka dorëzuar deklaratën nën betim. Prandaj gjykata në kuptim të nenit 37 par.3 vendosi këtë çështje në mungesë të shkresave të lëndës pasi që nga provat e administruara nuk arriti të konstatoj si të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në procedurë administrative, andaj vendosi që të anulohet vendimi nr.29495 të datës 19.09.2018 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave pranë Komunës së Kamenicës si dhe vendimi nr. 30618 i datës 02.09.2014 i Kuvendit Komunal Kamenicë.

Dhoma e Shkallës Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes gjen se aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat gjykata i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA-së lidhur me nenin 194 të LPK-së, dhe as me shkelje sipas pretendimeve në ankesë, sepse procedura në gjykatë të shkallës së parë është zhvilluar ashtu siç parashihet me ligj, dhe ligjshmëria e aktit administrativ përfundimtar–vendimit të paditurës, si në vështrim të nenit 37 paragrafi 3 dhe 44 të LKA-së, është vlerësuar drejtë, bazuar në pretendimet në padi, përgjigjes në padi si dhe të provave dhe dëshmime të administruara në seancë gjyqësore.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë ka vendosur drejtë, duke u bazuar në nenin 37 të LKA-së, referuar edhe nenit 10 paragrafi 8 i Ligjit për Prokurimin Publik në të cilin është përcaktuar se “Autoriteti kontraktues gjithashtu do ti sigurojë qasje dhe kopje të shënimeve dhe informatave një gjykate kompetente, nëse qasja ose kopjet e tilla kërkohen nga një urdhër i nxjerrë nga gjykata e tillë. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti sigurojë qasjen dhe kopjet e kërkuara në mënyrë të rregullt dhe pa pengesa”. Andaj në interpretimin e drejtë të këtyre dispozitave ligjore kuptohet se e paditura nuk iu ka përmbajtur obligimeve ligjore ti dorëzojë zarfin kopje të mbyllur apo procesverbalin e hapjes së këtij zarfi në mënyrë që të vërtetohet gjendja faktike e konstatuar nga i padituri në vendimin kontestues dhe atë se anëtari i konzorciumit nuk e ka dorëzuar deklaratën nën betim.

Andaj, kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë ka vendosur kur e ka anuluar vendimet e organit administrativ, vendimin nr.29495 të datës 19.09.2018 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave dhe vendimin nr.30618 të datës 02.09.2014 të Kuvendit Komunal Kamenicë.

Në raport me pretendimet ankimore të paditurës se me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit KA.nr96/2023, gjykata nuk ka marr për bazë dispozitën e nenit 16 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se “Akti administrativ nuk mund të kundërshtohet për aplikim jo të drejtë të dispozitave, kur organi kompetent ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në bazë të autorizimeve dhe në kuadër të kufijve që i janë dhënë me dispozita ligjore, në pajtim me qëllim për të cilin i është dhënë autorizimi”, këtë pretendim Kolegji e refuzon si të pa bazuar, për faktin se i padituri ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 8 të Ligjit për Prokurimin Publik duke mos iu përmbajtur obligimeve të vendimit të gjykatës për sjelljen e kopjes së pa hapur të ofertës së paditësve për të vërtetuar saktë gjendjen faktike në këtë çështje administrative.

Ndërsa sa i përket e pretendimeve se në arsyetim të aktgjykimit, me rastin e administrimit të provave materiale nuk është cituar në asnjë pjesë të tij se është administruar si provë deklarata nën betim e operatorit ekonomik “Agrounion” ShPK, por gjykata vetëm është

lëshuar në atë se e njëjta ka ekzistuar, që do të thotë se kemi konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Këtë pretendim Dhoma e Shkallës së Dytë e refuzoi si të pa bazuar për arsye se në shkresat e lëndës gjenden dokumentet deklarata pjesëmarrjeje e datës 21.05.2014 e nënshkruar nga R.SH.1. nga Agrounion ShPK dhe deklarata në betim e datës 21.05.2014 e të njëjtit subjekt. Në anën tjetër e paditura pranë gjykatës nuk ka dorëzuar provat as me përgjigje në padi me të cilin aktvendim ka qenë i obliguar të dorëzoj të gjitha shkresat e lëndës me të cilat do të mund të vërtetohen pretendimet lidhur me gjendjen faktike të kontestuar, po ashtu e paditura ka qenë e obliguar edhe përmes aktvendimit të datës 06.07.2023 nuk ka dorëzuar provat me të cilat do të mbështeste pretendimet e tij. Andaj Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj ankesa e paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.12/24, me datë 24.05.2024

**Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami**